REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Drejtoria Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve
Sektori i Transparencës dhe Komunikimit

Lënda: *Minutat e takimit nga diskutimi i publikut për draft VKM-në "Për miratimin e listës së ndotësve organik të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre"*

Ditën e martë datë 05.05.2015, në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për projektvendimin e këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së ndotësve organik të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre".

Në këtë takim merrnin pjesë këta përfaqësues të Shoqërisë Civile:
Z. Sazan Guri, G&G group,
Z. Erlind Muho, ekspert,
Z. Artan Manusha, ZQMM,
Znj. Esmeralda Buzhiqi, MeNV Group,
Z. Gezim Shehu, ekspert,
Z. Fran Shkafja, ekspert,

Nga Ministria e Mjedisit morën pjesë këta përfaqësues:

Znj. Laureta Dibra, Përgjegjëse e sektorit të të Ajrit, Kimikateve dhe Ndryshimeve Klimatike;
Znj. Rovena Mone, specialiste, Sektori i Ajrit, Kimikateve dhe Ndryshimeve Klimatike;
Znj. Jonila Haxhillari, specialiste, Sektori i Ajrit, Kimikateve dhe Ndryshimeve Klimatike;
Znj. Enkelejda Malaj, Përgjegjëse e Sektorit të Transparencës dhe Komunikimit;
Znj. Sabina Cenameri, Specialiste, Sektori i Programimit dhe Koordinimit ndërinstitucional;

Dëgjesa u hap nga **znj. Laureta Dibra**, Përgjegjëse e sektorit të të Ajrit, Kimikateve dhe Ndryshimeve Klimatike, e cila njohi të pranishmit me situatën e përgjithshme të legjislacionit për kimikatet në vendin tonë, duke sqaruar se ky projektvendim vjen si një pjesë e paketës së plotë për kimikatet, që është duke u hartuar nga Ministria e Mjedisit, në kuadër të përafrimit të legjislacionit tonë me atë Europian.

Më tej, fjalën e mori **Znj. Rovena Mone**, specialiste, Sektori i Ajrit, Kimikateve dhe Ndryshimeve Klimatike, e cila bëri një prezentim të detajuar të përmbajtjes së projektvendimit, duke u përqendruar në risitë që sjell ky projektvendim në përmirësimin e situatës së menaxhimit të kimikateve në vendin tonë.

Znj. Mone sqaroi se përveç detyrimit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë Europian, ky projektvendim vjen edhe si një detyrim në kuadër të Konventës së Stokholmit për ndotësit organik të qëndrueshëm dhe Konventës së Roterdamit, në të cilat Shqipëria është palë prej vitesh.

Ajo sqaroi se ky projektvendim rendit detyra dhe përgjegjësi të ndara si për Ministrinë e Mjedisit, për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, por edhe struktura të tjera kombëtare, si: doganat.

Znj. Laureta Dibra sqaroi se projektvendimi nuk flet thjesht për mbetje, por për kimikate, në gjendje të pastër ose të përzier, për rregullat para hedhjes së tyre në treg, për rregullat e importit, sasitë, përqindjet dhe afatet. Projektvendimi flet, ashtu si edhe Direktiva Europiane, për ndalime dhe kufizime të lëndëve të caktuara apo sasive të tyre.

Z. Sazan Guri pyeti nëse Ministria kishte evidentuar kompanitë që importojnë, përdorin apo tregtojnë ndotës organik të qëndrueshëm, si edhe lëndët që ata përdorin e që kategorizohen si ndotës organik të qëndrueshëm.

Znj. Laureta Dibra u përgjigj se gjatë këtyre viteve Ministria nuk ka patur kërkesa nga bizneset për të marrë autorizim për përdorim të NOQ, me përjashtim të një rasti, të një spitali privat, për të cilin Ministria nuk lëshoi autorizim, pasi ende nuk kishte miratuar kuadrin ligjor të nevojshëm, por ky projektvendim krijonte bazën e nevojshme ligjore për të menaxhuar këto kërkesa dhe situata, duke qenë se lista e NOQ do të futet automatikisht në sistemin doganor, duke mos lejuar hyrjen në vend të lëndëve që renditen në listën e NOQ të ndaluara, e duke i kërkuar subjektit autorizimin përkatës për lëndë me kufizime.

Z. Sazan Guri pyeti se përse duhej shtuar marrja e autorizimit nga Ministria e Mjedisit dhe se a nuk përbënte kjo një rast për mundësi abuzimi.

Znj. Enkelejda Malaj sqaroi se autorizimi bëhet i nevojshëm për listën e kufizuar, pasi kufizimi nënkupton që lënda mund të importohet, por kriteret e sasisë që lejohet, arsyes përse duhet të lejohet dhe afatet e importimit duhet të verifikohen nga ekspertë të Ministrisë së Mjedisit dhe jo nga stafet doganore, që nuk mund të bëjnë verifikime të tilla.

Z. Sazan Guri pyeti se si do të maten sasitë e NOQ që çlirohen nga djegiet e mbetjeve dhe se a kemi ne kapacitete që mund të bëjnë matje të besueshme?

Znj. Laureta Dibra u përgjigj se nëpërmjet këtij projektakti Ministria vendos rregulla për kimikatet sipas legjislacionit Europian, ndërsa Ligji për Lejet Mjedisore vepron në të tilla raste si për çdo lloj ndotje tjetër, pra është Leja Mjedisore e lëshuar për një veprimtari të caktuar që përcakton kushtet e ushtrimit të aktivitetit dhe minimizimit të ndotjes mjedisore.

Znj. Laureta Dibra vijoi me sqarimin për kapacitetet njerëzore, duke thënë se me miratimin e Ligjit të ri për Kimikatet, Ministra shpreson se ashtu si gjithë vendet e tjera të rajonit, ne do të mund të ngrejmë Agjencinë Kombëtare të Kimikateve, e më tej të hartojmë Regjistrin Kombëtar të Kimikateve, si edhe të bëhen studimet e nevojshme për situatën aktuale.

Z. Sazan Guri sugjeroi se është me rëndësi bërja e studimeve për të mbledhur gjetje në terren përsa i përket situatës së dioksinave dhe furaneve, që çlirohen në ajër, apo situatës së përgjithshme pranë landfilleve dhe praninë e NOQ në tokë e ujrat pranë këtyre terreneve të ndotura, dhe se vetëm pas këtyre studimeve mund të kalosh në hapin tjetër, dhe se për këtë Ministria ka për detyrë të bëjë propozimet e duhura në vendet e duhura.

Dëgjesa u mbyll me falenderimet e rastit.

Për çdo koment tjetër a sugjerim për përmbajtjen e projektaktit, lutem shkruani në adresën elektronike zyrtare të Ministrisë së Mjedisit që është info@moe.gov.al